

Projekti për zhvillimin e kanalizimit në Gjilan

Vendi:	KOSOVË
Numri i Projektit:	50437
Spektori i biznesit:	Inf. komunale dhe mjedisore
Lloji i njoftimit:	SHTETËROR
Kategoria mjedisore:	B
Data e synuar e bordit:	25 prill 2019
Statusi:	Koncepti i shqyrtuar 25
DPF e publikuar:	shtator 2018

Përshkrimi i projektit

Ofrimi i një kredie sovrane deri në 10 milionë euro për Qeverinë e Kosovës që do t'i jepet kompanisë rajonale të ujësjellësit "Hidromorava" ("KRU HM" ose "Kompanisë") si grant për ta financuar një pjesë të zgjerimit dhe rehabilitimit të rrjetit të grumbullimit të ujërave të zeza dhe ndërtimit të një impianti të ri të trajtimit të ujërave të zeza ("ITUZ"). Kredia do t'i trajtojë nevojat kritike për trajtimin e ujërave të zeza në qytetin e Gjilanit dhe komunat fqinje dhe nga ajo do të përfitojnë rreth 110,000 banorë. Ky projekt do të bashkëfinancohet me Bankën Evropiane të Investimeve ("BEI").

Objektivat e projektit

Financimi do t'ia mundësojë Kompanisë ta rehabilitojë, përmirësojë dhe zgjerojë rrjetin e ujërave të zeza dhe ta ndërtojë një ITUZ të ri të centralizuar me qëllim të mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të zeza sipas standardeve përkatëse mjedisore të BE-së. Zbatimi i projektit do të rezultojë me përfitime të konsiderueshme mjedisore për burimet lokale të ujit të freskët duke i ulur në masë të konsiderueshme vëllimet e ujërave të zeza të papërpunuara dhe ngarkesat ndotëse që ndërlidhen me to dhe që do të shkarkohen drejtpërsëdrejti në lumë. Pritet që ky projekt ta rrisë numrin e njerëzve të lidhur në rrjetin e kanalizimit në zonën e shërbimit të kompanisë.

Ndikimi i tranzicionit

I mirë

Burimet e ndikimit të tranzicionit janë:

1) Të gjelbra. Projekti pritet ta shtojë numrin e lidhjeve në rrjetin e kanalizimit dhe ta arrijë pajtueshmërinë me standardet mjedisore të BE-së në trajtimin e ujërave të zeza.

Projekti e mbështet plotësisht qasjen e agjendës së Tranzicionit të Ekonomisë së Gjelbër të Bankës duke financuar investime që sjellin dobi mjedisore dhe që i zbusin efektet e ndryshimeve klimatike.

2) Të qeverisura mirë. Banka do ta mobilizojë asistencën teknike për t'i përmirësuar kontratat ekzistuese për shërbime publike ("KShP-të") midis kompanisë dhe komunave të cilave u shërben. Projekti po ashtu do t'i mbështesë përmirësimet në qeverisjen e përbashkët nëpërmjet Programit të Përmirësimit Financiar dhe Operacional (PPFO) me qëllim të rritjes së performancës menaxheriale.

Informatat për klientin

SOVRANI I KOSOVËS

Përfutuese e këtij projekti është KRU HM, e cila është shoqëri aksionare në pronësi të plotë të qeverisë. Kompania i menaxhon dhe operon sistemet e ujit dhe kanalizimit në shtatë komuna (Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Kllokot, Ranillug dhe Partesh) duke u shërbyer rreth 30,000 familjeve dhe klientëve komercialë dhe institucionalë dhe duke e mbuluar një zonë të shërbimit me një popullsi prej afro 170,000 banorëve.

Përmbledhja e financimit nga BERZh-i

10,000,000.00 euro

Hua sovrane për Qeverinë e Kosovës që do t'i jepet si grant KRU HM-së.

Gjithsej kostoja e projektit

24,300,000.00 euro

Përmbledhja mjedisore dhe sociale

Është kategorizuar B në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale 2014 të BERZh-it. Kujdesi i Duhur Mjedisor dhe Social (KDMS) për këtë projekt është kryer si pjesë e Studimit të Fizibilitetit nga konsulentët e pavarur. Kjo e ka përfshirë një rishikim të praktikave aktuale, një vlerësim të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale (M & S) të projektit dhe një rishikim të sistemeve dhe kapaciteteve të kompanisë për menaxhimin e M & S. PIP është hartuar për ta arritur pajtueshmërinë me standardet e trajtimit të ujërave të zeza kombëtare dhe të BE-së dhe me kërkesat e performancës të BERZh-it (KP-të). Për projektin është hartuar dhe dakorduar një Plan i Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS). Një Plan i Angazhimit të Akterëve (PAA) dhe një përmbledhje joteknike (PJT), duke përfshirë një pasqyrë të masave kryesore për zbutjen dhe menaxhimin mjedisor, janë hartuar dhe publikuar nga klienti lokalisht në faqen e tij të internetit.

Projekti do të sjellë dobi të konsiderueshme mjedisore dhe shëndetësore në krahasim me gjendjen ekzistuese duke i përmirësuar shërbimet e menaxhimit të ujërave të zeza në Komunën e

Gjilanit përmes ndërtimit të një impianti të ri për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ) me kapacitet prej 76,000 P.E.

(Faza I) dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Gjilanit dhe disa komuna fqinje. Aktualisht në zonat rurale nuk ekzistojnë sisteme të centralizuara të kanalizimit dhe ujërat e zeza të patrajuara aktualisht shkarkohen drejtpërsëdrejti në lumenjtë Mirushë dhe Moravë dhe përfundimisht në Danub. Projekti do të rezultojë në një reduktim të ndjeshëm të ndotjes së burimeve lokale të ujit falë përmirësimit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Projekti do të rezultojë në 3.3 milionë m³ ujëra të zeza të trajtuara në vit pas Fazës I. Popullsia e përgjithshme që do të përfitojë nga qasja e përmirësuar në shërbimet e kanalizimit do të jetë 110,000 njerëz, me 10,000 qytetarë të tjerë që do të lidhen me rrjetin e kanalizimit. Faza e ardhshme II, e cila nuk është pjesë e projektit aktual, parashikohet ta rrisë kapacitetin e përgjithshëm të ITUZ-it në 114.000 P.E., ta sjellë mënjanimin e avancuar të substancave ushqyese dhe të rrisë vëllimin e rrjedhave të trajtuara deri në 4.5 milionë m³/vit.

Projekti nuk pritet të ketë ndikim të konsiderueshëm në biodiversitetin për shkak të përdorimit të tokës kryesisht bujqësore. Lokacioni i projektit nuk është as brenda, as në afërsi të ndonjë zone të mbrojtur me vlerë të lartë ekologjike, ndërsa nuk përfshihen zona të ndjeshme. Në vlerësimin e përbalueshmërisë që e ka bërë konsulentin nuk janë identifikuar shqetësime të mëdha sa i përket përbalueshmërisë së tarifave të kanalizimit nga zbatimi i projektit.

Për këtë projekt nuk do kërkohet kurrfarë zhvendosjeje fizike, ndërsa nuk ka objekte banimi brenda rrezes prej 500 metrave nga ITUZ-i. Projekti përfshinë blerjen e tokës (rreth 37 parcelave të tokës bujqësore private) për qëllimin e ndërtimit të ITUZ-së dhe për rrugën për qasje në lokacionin e impiantit afër fshatit Uglarë në Lumin Morava, i cili do të ndikojë në një zhvendosje ekonomike. Është përgatitur dhe shpalosur Korniza për Blerjen e Tokës dhe Restaurimin e Jetesës (KBTRJ) në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe KP5 të BERZh-it për këtë projekt, duke përfshirë një matricë të të drejtave dhe një mekanizëm për konsultime publike dhe ankesa. Procesi i blerjes së tokës për këtë projekt nuk ka përparuar aq sa duhet për ta hartuar një Plan për Blerjen e Tokës dhe Restaurimin e Jetesës (PBTRJ), prandaj kjo duhet të përgatitet para realizimit aktual të blerjes së tokës dhe aktiviteteve ndërtimore për këtë projekt, siç kërkohet nga ESAP-i. Ndiurma pas nënshkrimit për zbatim do t'i ofrohet Kompanisë për të mbështetur zbatimin e përgjithshëm të PVMS-së, duke përfshirë përgatitjen e PBTRJ-së.

Çdo ndikim negativ do të lokalizohet, do të jetë i përkohshëm dhe do të parandalohet ose zbutet duke iu përmbajtur praktikave të mira të ndërtimit. Ndikimet e identifikuar përfshijnë zhurmën, ndotjen e ajrit, qasjen e kufizuar në ndërtesa dhe rrugë, efektin e mundshëm të vibrimit në ndërtesa, trazimin e tokës dhe të peizazhit gjatë punimeve të gërmimit, copërat, dëmtimet dhe bllokimin e trafikut. Të gjitha ndikimet e mundshme negative mund të menaxhohen përmes masave të përshtatshme zbutëse. Plani i reagimit emergjent do të miratohet për t'u marrë me ndotjen aksidentale dhe/ose fatkeqësitë natyrore. Emetimet e pluhurit do të minimizohen duke e optimizuar trafikun e ndërtimit, duke iu përmbajtur kufizimeve të shpejtësisë dhe duke e përdorur ujin si shtypës të pluhurit.

KRU "Hidromorava" nuk ka sistem të duhur të menaxhimit mjedisor dhe social dhe nuk ka personel kompetent për mjedis, shëndet dhe siguri (MShS) në nivel të kompanisë. Për të arritur pajtueshmërinë me KP-të e BERZh-it është e nevojshme që kompania ta krijojë një Sistem të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (SMMS) efektiv, i cili i mbulon çështjet mjedisore, të shëndetit social dhe sigurisë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare, siç janë ISO14001 dhe OHSAS 18001/ISO 45001. Kompanisë do t'i duhet ta hartojë një politikë të korporatës për M & S dhe t'i përcaktojë standardet themelore për MShS (për vlerësim të rrezikut dhe ndikimit, planifikim, monitorim dhe raportim). Kërkohet zbatimi i një qasjeje më sistematike për menaxhimin e rreziqeve mjedisore, sociale dhe të punës për t'u siguruar që kompania ta realizojë projektin në përputhje me kërkesat mjedisore kombëtare dhe standardet e kanalizimit urban të BE-së.

Me PVMS kërkohet që kompania të bëjë një numër përmirësimesh të dizajnuara për t'i përmbushur KP-të e BERZh-it. Veprimet kryesore të PVMS-së ndërlidhen me: rritjen e kapacitetit të kompanisë për MShS dhe zhvillimin e procedurave për MShS që kanë të bëjnë me rreziqet kryesore ndaj MShS-së; përpilimin e dokumenteve të projektimit dhe përgatitjen e VNMS-së lokal për procedurën e dhënies së lejeve; marrjen e lejeve të ndërtimit për impiantin e ujërave të zeza dhe tubacionet e kolektorëve dhe lejen për shkarkimin e rrjedhave; hartimin e politikave dhe procedurave të BNj-ve; përmirësimin e mekanizmit të ankesave të punëtorëve; hartimin dhe zbatimin e PBTRJ-së para ndërtimit; hartimin e një plani të menaxhimit dhe monitorimit të fazës së ndërtimit dhe M&S; gjurmimet dhe kanalim; procedurat e shëndetit dhe sigurisë në punë (ShSP-së); përmirësimin e monitorimit të cilësisë së ujërave të zeza dhe objekteve laboratorike; zotimin për realizimin e mënjanimin të avancuar të substancave ushqyese nën Fazën II të ITUZ-it; menaxhimin e erërave në objektet e ITUZ-it; planifikimin e menaxhimit dhe deponimit të llumit; zbatimin e PSM-së së bashku me mekanizmin publik të ankesave.

Banka do ta monitorojë zbatimin e projektit dhe PVMS-së si dhe performancën mjedisore dhe sociale të kompanisë duke i shqyrtuar raportet vjetore mjedisore dhe sociale të kompanisë dhe duke ndërmarrë vizita monitoruese sipas nevojës.

Bashkëpunimi teknik

Para nënshkrimit:

- BT1 - Analiza e hendekut e studimit të fizibilitetit, duke përfshirë kujdesin e duhur mjedisor dhe social. Kostoja e detyrës është 58,500 euro, e bashkëfinancuar së bashku me BEI-në.

Pas nënshkrimit:

- BT2 - Ndhima në prokurim dhe zbatimin për Njësinë e Zbatimit të Projektit (NZP-në). Vlerësohet se kostoja e detyrës është 400,000 euro, që do të financohet nga Korniza Evropiane e Investimeve në Ballkanin Perëndimor – KIBP-ja.
- BT3 - Programi i Përmirësimit të Performancës Financiare dhe Operacionale, duke përfshirë rishikimin e KDP-së dhe Planin e Menaxhimit të Aseteve të Infrastrukturës. Kostoja e detyrës vlerësohet në 300,000 euro, që do të financohet nga një donator ndërkombëtar ose nga Fondi Special i Aksionarëve të BERZh-it.

Të dhënat kontaktuese të kompanisë

Muhamed Suliqi

info@kru-”Hidromorava”.com

+381 0280 321 104

<http://kru-”Hidromorava”.com>

Vellezerit Gervalla p.m 60000 Gjilan

Mundësitë për biznes

Për mundësitë e biznesit apo prokurim, kontaktoni kompaninë kliente.

Pyetjet e përgjithshme

Pyetjet për projektin e BERZH-it që nuk ndërlidhen me prokurimin: Tel: +44 20 7338 7168; Faks. +44 20 7338 7380

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika e informimit publik (PIP)

PIP përcakton se si BERZH-i i shpalos informatat dhe konsultohet me aktorët në mënyrë që të ngrisë vetëdijen dhe kuptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe veprimtarive të saj.

[Teksti i PIP](#)

Mekanizmi i projektit për ankesa (MPA)

BERZH-i e ka themeluar Mekanizmin e Projektit për Ankesa (MPA-në) për ta ofruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose më shumë individë ose nga organizatat në lidhje me projektet e financuara nga Banka të cilat supozohet se kanë shkaktuar ose mund të shkaktojnë dëm.

[Rregullorja e Punës që e rregullon MPA-në](#) | [Versioni në rusisht](#)

Çdo ankesë sipas MPA-së duhet të dorëzohet jo më vonë se 12 muaj pas shpërndarjes së fundit të fondeve të BERZH-it. Ju mund të kontaktoni me Zyrtarin e MPA-së (në pcm@ebrd.com) ose me Zyrës së Vendit të BERZH-it për ndihmë nëse nuk jeni të sigurt për periudhën brenda së cilës duhet të parashtrahet ankesë.